



PROJ

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E BRENDSHM

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 363 prot

Tiranë, më 3 11 2022.

VENDIM

Nr. 6, datë 28/10/2022

PËR
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 28.10.2022

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi në mbledhjen e datës 28.10.2022 vendosi:

1. Për "**Buxhetin e vitit 2023 për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore**" propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

- a. Rritjen e Transfertës së pakushtëzuar, mbi 1% të Produktit të Brendshëm Bruto.

Ecuria e procesit të reformës së decentralizimit ka nxjerrë si domosdoshmëri rritjen e % së transfertës së pakushtëzuar nga 1% të PBB në 1.2 -1.4 %, si fillim, që qeverisja vendore të ketë më shumë buxhet për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë, ku në fakt ka çaluar dhe është nën standardet minimale bashkëkohore, si shërbimet e pastrimit dhe mbetjeje urbane, furnizimi me ujë të pijshëm e kanalizimet, infrastruktura rrugore, ujitëse, mirëmbajtjen e rezervuarëve, mbrojtjen nga zjarri, administrimin e pyjeve, emergjenca civile etj.

- b. Përmirësimin e formulës së transfertës së pakushtëzuar 2023:

Sipas aneksit 1 të p/buxhetit 2023, 80 % e transfertës së pakushtëzuar alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Kjo formulë diskriminon bashkitë e varfëra të zonave minerare, me popullsi të vogël dhe me tendencë në rritje të largimeve për shkak edhe të kushteve të infrastrukturës. Sugjerojmë që të ulët % e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e popullsisë relative në

35- 40 %, duke drejtuar fondet drejt shtrirjes së shërbimeve publike dhe investimeve në rrugë, kanalizime, pyje etj.

Duke krahasuar tabelën nr. 3 transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2023 në vitet 2022 dhe 2021, rezulton se bashkitë e zonave minerare nuk janë mbështetur financiarisht për pjesën e rentës minerare që përfitonin përpara ndryshimit të ligjit 9975/2006 “Për taksat kombëtare” dhe ligjit 68/2017 “Për financat vendore”, duke vështirësuar edhe me shumë mundësitë për investime apo mirëmbajtjen e rrugëve, kanaleve vaditëse, etj., ndërsa ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 34, pika 5 detyron kompensimin e uljes së të ardhurave, nëpërmjet rritjes së transfertës financiare.

- c. Rritjen e ndjeshme të transfertës së pakushtëzuar sektoriale (nga krahasimi i tabelave në vite për transfertën e kushtëzuar):

Për rrugët rurale, transferta mbetet pothuaj në nivelet e fondeve të transferuara në vitin 2016, ndërsa gjendja e rrugëve rurale dhe veçanërisht ato mes fshatrave është për të dëshiruar (sipas inventarit janë rreth 9500 km). Akoma nuk janë miratuar standardet minimale për rrugët, pra dhe mbi këtë bazë të llogaritet buxheti përkatës si transfertë e kushtëzuar, ose të jepen fonde shtesë mbi bazën e projekteve të hartuara, miratuara nga bashkitë dhe të monitoruara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Për mbrojtjen nga zjarri kërkohet rritje e konsiderueshme e buxhetit, pasi gjendja e pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarreve është jashtë standardeve infrastrukturore dhe janë të pamjaftueshme. Rritja është vetëm 74.000 mijë lekë ndaj vitit të kaluar;

Për ujitjen dhe kullimin dhe mbrojtjen e rezervuarëve, gjendja po vështirësohet, pasi prej vitit 2020 nuk janë bërë investime nga buxheti i shtetit dhe transferta e kushtëzuar është rritur vetëm 33.000 mijë lekë ndaj vitit 2022. Bashkitë kanë hartuar projekte dhe prej vitesh presin financimin e tyre;

Administrimi i pyjeve i transferuar tek pushtetit vendor është mbështetur vetëm me 20.000 mijë lek, si transfertë e kushtëzuar për numrin e punonjësve dhe shpenzimeve operative. Mundësitë e bashkive për investime për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve dhe turizmin janë shumë të kufizuara. Duhet theksuar se përpara transferimit të pyjeve, buxheti i shtetit ka investuar për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve, mbjelljet e reja, etj, por bashkitë akoma nuk po arrijnë të mbështesin me fonde për investimin, ruajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor dhe buxheti i shtetit nuk ka akorduar fonde për pyjet;

Menaxhimi i mbetjeve urbane në vitin 2023, për herë të parë është mbështetur me 700 milion lekë në 30 bashki, megjithëse shumica e bashkive kanë problematika me vendgrumbullimet, transportin e mbeturinave nga njësitë e qeverisjes vendore etj;

Emergjenca civile, megjithëse përgjegjësi e pushtetit vendor, është trajtuar si transfertë e kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore për t’u akorduar nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me “formulë”, në raport me buxhetin e bashkisë, ndaj totalit të buxhetit të gjithë bashkive. Kjo ndarje krijon mundësi për subjektivizëm dhe nuk favorizon bashkitë me të ardhura të kufizuara për të marrë masa për mbrojtjen civile. Gjithashtu nuk zgjidh problemin e mbetur prej vitesh për pagesën e dëmeve të shkaktuara nga zjarret, tërmetet, etj. në vite, të miratuara nga Këshillat Bashkiake dhe Prefekti, por të pa likuiduara më parë për mundësi fondesh;

Të ketë mbështetje të vazhdueshme të reformës në arsimin parashkollor, duke garantuar uljen e numrit të fëmijëve të klasave/grupeve përdedukatore deri në 15 fëmijë, shtimin e fondeve për numrin

e edukatoreve, mbështetje në bashkitë e varfëra që kanë me pak fëmijë në kopshte dhe shtim fondi për stafin mësimor;

Të mbahen në konsideratë rritja e çmimeve të shërbimeve, materialeve, kostoja e ndërtimeve etj, që ndikon ndjeshëm në buxhetin vendor dhe uljen e shtrirjes dhe cilësisë së shërbimeve e kryerjen e investimeve. Në rastet kur bëhen shtesa të buxhetit të shtetit etj, duhet mbajtur në konsideratë patjetër edhe shtesa ose korrektimi i buxhetit vendor, si efekt i rritjes së çmimeve dhe luftës në Ukrainë, për të mbrojtur shërbimet publike ndaj qytetarëve, investimet etj.

Të rishikohet renta minerare, me marrëveshje është lënë që 50% të rentës t’iu alokohet bashkive, por akoma nuk është finalizuar.

Të rishikohet rritja e pagave për punonjësit e bashkisë për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

2. Për projektligjin **“Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”**, propozuar nga Kryeministria, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

Për nenin 9 “Titulli Qytetar nderi”:

- a) Neni 9 të riformulohet “Titulli Qytetar nderi i bashkisë”. Shtesa “i bashkisë”, argumentohet me pikën 1, 1.7, “a” të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” dhe shkronjën “m” të nenit 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, pra titujt e nderit janë e drejtë dhe përgjegjësi e këshillit bashkiak që shqyrton dhe miraton vendimin për titullin e nderit, dhe kjo duhet theksuar në vendim;
- b) Në pikën 1 të shtohet shprehja “kontribute dhe merita të veçanta në shërbim...”, duke u riformuluar: Titulli “Qytetar Nderi i Bashkisë” jepet nga këshilli bashkiak, për veprimtari të shquar, kontribute dhe merita të veçanta në shërbim dhe në dobi të bashkisë ose për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit, brenda territorit të bashkisë “. Kjo shtesë plotëson dhe zgjeron motivacionin e dhënies së titullit qytetar nderi;
- c) Pika 2 të riformulohet, duhet hequr shprehjen “në çdo rast”, si e panevojshme dhe nuk kufizohet nga ligjin 139/2015, neni 54 dhe të shtohet motivacioni për dhënien e titullit qytetar nderi personaliteteve të huaja apo donatorëve që kanë kontribute në dobi të bashkisë dhe interesave të komunitetit: Titulli “Qytetar Nderi i Bashkisë” i jepet edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë që vizitojnë bashkinë në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore ose dhe personaliteteve të huaja apo donatorëve që kanë kontribute në dobi të bashkisë dhe interesave të komunitetit të saj.
- d) Të shtohet pika 3. Ky titull nuk u jepet personave që janë bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit, personave që janë të përcaktuar nga ligji për lustracionin apo personave të dënuar për vepra të rënda apo abuzime sipas përcaktimeve ligjore.

Për nenin 10 “Titujt e veçantë të nderit”:

- a) Pika 1 të ndryshojë, duke mos përcaktuar të drejtën e njësisë së qeverisjes vendore për krijimin dhe dhënien e jo më shumë se dy titujve vendor, pasi ky kufizim bie në kundërshtim me ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” (pika 1.7.a) dhe nenin 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” (shkronja m) dhe të riformulohet: “Njësia e vetëqeverisjes vendore ka të drejtë të krijojë dhe të japë tituj të veçantë vendor, për të shprehur mirënjohjen e posaçme për veprimtarinë e shquar në dobi të komunitetit të saj”.

- b) Të shtohet një pikë 'bashkitë duhet të miratojnë listën e titujve të veçantë dhe t'a publikojnë atë,
çdo bashki duhet të depozitojë pranë Ministrisë së Brendshme, listën e titujve të miratuar nga VKB. Ministria e Brendshme i arkivon dhe ua shpërndan prefekturave këtë VKB me listën e titujve.
- c) Pika 1. ...NJVV nuk duhet të japin me shumë se dy tituj të veçantë.... arsyen e kufizimit për tituj të veçantë, ndërkohë që këtë kufizim se keni për nenin 9 "Qytetar Nderi".

Për Nenin 12 "Kërkesa për ushtrimin e nismës ose propozimit":

- a) Në pikën 1 të shtohet si kërkues të nismës dhe propozimit dhe institucionet qendrore publike, shkencore dhe shoqatat në nivel kombëtar etj. Kjo shtesë, krahas kërkesës së qytetarëve (shtetasve) siç është formuluar në projektligj, përfshin strukturat qendrore shtetërore dhe publike, institucione shkencore dhe shoqata në nivel kombëtar brenda dhe jashtë vendit që mund të propozojnë tituj nderi si "Ambasador i Kombit", "Qytetar Nderi i RSH", "Qytetar Nderi i Bashkisë" etj. Kjo shtesë argumentohet me faktin që këto struktura kanë më shumë mundësi të japin propozime të argumentuara sipas përcaktimeve të neneve 6, 7, 9 e 10 dhe nuk mund të kufizohen në kërkesat e tyre për propozim për titujt e nderit;
- b) Pika 1 të riformulohet si vijon: "Organet e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre të nismës dhe propozimit edhe duke u mbështetur në kërkesat dhe propozimet e institucioneve qendrore publike, institucioneve shkencore dhe shoqatave në nivel kombëtar dhe kërkesave të shtetasve të paraqitura për këtë qellim, sipas parimeve dhe kërkesave të këtij ligji";
- c) Në pikën 2 të shtohen institucioneve qendrore publike, institucioneve shkencore dhe shoqatat në nivel kombëtar, sipas argumentit të shtesës në pikën 1 të nenit 12, duke e riformuluar, si vijon: "Çdo institucion qendror publik, institucion shkencor, shoqata në nivel kombëtar etj, çdo shtetas, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për ushtrimin e të drejtës së nismës ose propozimit, për një shtetas të caktuar ose shtetas të huaj, në një nga institucionet që e kanë këtë të drejtë, sipas nenit 11. Në këtë rast, kërkesa duhet të arsyetohet edhe shkaqet për të cilat shtetasi kërkon ushtrimin e të drejtës së nismës ose propozimit. Kërkesa nuk mund të paraqitet për nderimin e vetvetes";

Për nenin 14 "Komisioni këshillimor":

- a) Përbërja e Komisionit Këshillimor të jetë me 7 anëtarë, 3 anëtarë të jenë nën varësinë e institucionit propozues dhe 4 anëtarë të jenë personalitete të fushave përkatëse. Kjo përbërje rrit cilësinë e punës të Komisionit Këshillimor. Përbërja e anëtarëve të jashtëm të Komisionit Këshillimor të bashkive, të jetë nga personalitete vendore.

Për nenin 16 "Shqyrtimi i propozimit":

- a) Në pikën 2 të shtohet që komisioni kërkon informacione shtesë nga institucionet qendrore publike, institucionet shkencore dhe shoqatat në nivel kombëtar, shtetasit që kanë bërë propozimin, referuar propozimit tonë të bërë për përmirësimin e nenit 12, pika 1, duke e riformuluar si vijon: "Krahas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në nismën ose propozimin për nderim, komisioni kërkon informacione ose dokumentacion shtesë nga institucionet qendrore publike, institucionet shkencore dhe shoqatat në nivel kombëtar, shtetasit që kanë bërë propozimin dhe nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe nga çdo person fizik ose juridik apo organ publik vendas ose i huaj, që disponon të dhëna të vlefshme për shqyrtimin e plotë të nismës ose propozimit".

Për nenin 19. "Heqja e Titujve"

- a) Të hiqen titujt e dhënë nga NJVV për personat që janë bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit, personave që janë të përcaktuar nga ligji për lustracionin apo personave të dënuar për vepra të rënda apo abuzime sipas përcaktimeve ligjore.
3. Për projektligjin për "**Për bletarinë**", propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- a) Në paragrafin mbi "politika të qarta dhe në nivele përkatëse" është i domosdoshëm për çdo nivel operacional, duke filluar nga Shoqatat dhe Federata e Bletërritësve deri te institucionet shtetërore;
 - b) Neni 6 "Regjistrimi në Regjistër" të shtohet "NJVV", të cilat ndërtojnë në koordinim me Shoqatat Lokale dhe Ministrinë regjistrin e fermave bletërritëse. Kjo qëndron në hamoni dhe me përcaktimet e nenit 7, pika 6;
 - c) Neni 11, pika 4, "Burimet dhe administrimi i kullotave", të shtohet pas Ministrisë edhe "Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)".
4. Për projektligjin mbi "**Planin e Veprimit Kundër Helmimit të Llojeve të Kërcënuara dhe Endemike të Faunës së Egër në Shqipëri, 2022-2030**", propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- a) Në nënkapitullin 6.2.3. përfundime të analizës së mangësive ku thuhet: "Ndërgjegjësim i dobët i publikut të gjerë dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e incidenteve të helmimit", publiku nuk është i ndërgjegjësuar për shkallën e helmimit dhe impaktin në faunën e egër;
 - b) Drejtimi Strategjik 1, me anë të fletëpalosjes informuese Concersation Youth Club (CYC) është dhënë një informacion i mirë, edhe pse i shkurtër, mbi disa faktorë se përse ndodh helmimi, pasojat që ka në natyrë dhe se cilat janë disa nga alternativat paqësore me mjedisin që barinjtë/fermerët mund të mbrojnë të mirat e tyre;
 - c) Drejtimi strategjik 2.4. nënpika 2.4.6. grupimet e të rinjve, si aktorë mjaft të ndjeshëm ndaj helmimit të kafshëve, mund të përfshihen si pjesë e rrjetit të shkëmbimit të informacionit dhe të motivohen më tej;
 - d) Në pikën "Grupi i interesuar", në dokument nuk përfshihen NJVV si grup i tillë. Mendojmë se ka hapësirë të nevojshme për një përfshirje të tillë;
 - e) Në "Strukturat zbatuese" në planin e veprimit serish bashkia mungon;
 - f) Aksioni... bashkitë mund të luajnë një rol me rëndësi në aksionet e zbatimit të këtij dokumenti në territoret nën juridiksionin e tyre, por shkoj dhe me tutje duke sugjeruar edhe përfshirjen e këshillave të qarqeve;
 - g) Objektivat... pjesë e këtyre në forma të caktuara duhet të jenë bashkitë;
 - h) Drejtimit strategjike... nuk duhet të shmanget veprimi apo ndërveprimet me NJVV qoftë bashkitë apo qarqet;
 - i) Monitorimi... bashkitë dhe qarqet duhet të përfshihen në monitorin strategjikë, atë funksional dhe sipas rastit edhe operacional;
 - j) Në studimet dhe në takimet e organizuara për hartimin e Planit të Veprimit të përfshihen aktorë nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, meqenëse në territorin e bashkive bëjnë pjesë 80 % e pyjeve (ku jetojnë shpendët grabitqar) dhe të gjithë fermerët përdorin helme për luftimin e sëmundjeve dhe në raste të veçanta për të luftuar grabitqarët që dëmtojnë

prodhimet bujqësore, shpendët, etj. apo dhe përgjegjësia e bashkive për mbrojtjen e qenve të rrugës, etj.;

- k) Përfshirja në Grupin Kombëtar Kundër Helmimit, si organ këshillimor në ndihmë të qeverisë për orientimin e politikave dhe veprimet kundër helmimit të faunës së egër në Shqipëri të përfaqësuesve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, ndërsa siç e përmendëm më lart, ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ngarkon me përgjegjësi bashkitë për mbrojtjen e mjedisit e pyjeve dhe kjo reflektohet edhe në kapitullin e përgjegjësive dhe detyrave të Grupit Kombëtar Kundër Helmimit të Kafshëve të Egra;

Në pjesën e kuadrit ligjor të Planit të veprimit, në tabelën nr.1 “Autoritetet qeveritare përgjegjëse për punën kundër helmimit në Shqipëri”, sugjerojmë që:

- a) Te institucionet, ku është vendosur “Policia Bashkiake”, të jetë “Bashkia” dhe jo “Policia bashkiake” e cila siç e përmendëm më lart njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për këtë fushë, ndërsa policia bashkiake dhe strukturat e mbrojtjes së mjedisit dhe bujqësisë në bashki janë struktura vendore dhe jo institucion përgjegjës;
- b) Te përgjegjësia, të shtohet “bashkëpunim me strukturat shtetërore për ndihmë ndaj fermerëve e banorëve për ndalimin e përdorimit të helmeve ndaj faunës së egër”;
- c) Në tabelën 5 “Grupet e interesit të përfshirë në menaxhimin e incidenteve të helmimit në faunën e egër”, duhet të shtohet “Bashkia” dhe të përgjegjësia të shtohet “Strukturat përgjegjëse për pyjet, mjedisin, bujqësinë janë përgjegjëse për inspektimin për mbrojtjen e faunës së egër në pyjet ne administrim të bashkive dhe përdorimin e helmeve nga fermerët”;
- d) Të kapitulli mbi analizën e mangësive ndaj fenomenit të helmimit të grabitqarëve dhe faunës së egër, të shtohet edhe mungesa e protokolleve dhe bashkëpunimit mes institucioneve qendrore dhe vendore;
- e) “Plani i Veprimit”, duhet të ketë bashkëlidhur dhe analizën e buxhetit për zbatimin e tij. Ky dokument nuk ka bashkëlidhur buxhetin për zbatimin e tij për vitet 2020 – 2030 për të gjithë veprimtaritë dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit, megjithëse thuhet se është kalkuluar. Argumenti se buxheti është ai i parashikuar nga institucionet shtetërore dhe ai shpenzohet aktualisht nuk qëndron, veçanërisht për bashkitë, ku mundësitë financiare në shumicën e tyre janë të kufizuara, apo dhe për OJF të cilat kanë buxhete të kufizuara në vite dhe nga donatorë jo buxhetorë, duke rrezikuar zbatimin e projekteve kundër helmimit. Plani i Veprimit shtrin aktivitetin nga vitit 2022 deri në vitin 2030, prandaj buxheti për zbatimin e tij duhet të jetë në rritje dhe sipas aktiviteteve të parashikuara në këtë plan veprimi. Sugjerojmë që buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Helmimit të llojeve të kërcënuara dhe endemike të faunës së egër si për organet shtetërore dhe vendore, duhet të bashkërendohet dhe të jetë në përputhje me buxhetin afatmesëm;

Në Tabelën 6 “Aksionet e propozuara për të luftuar helmimin e faunës së egër në vend”, bashkëlidhur Planit të Veprimit, sugjerohet të bëhen këto përmirësime:

- f) Në Aksionin 1.1.1 “Zgjerimi i njohurive mbi faktorët që nxisin përdorimin e karremave helmues”, si përfitues të shtohen edhe “strukturat e administratës vendore”;
- g) Në Aksionin 1.1.3 “Investigimi i impaktit të grabitqarëve në zonat e gjuetisë dhe femat blegtorale” në strukturat zbatuese të përfshihen dhe “strukturat përkatëse të administratës vendore”;
- h) Në Aksionin 1.2.1 “Krijimi i një baze të dhënash për incidentet e helmimit të paligjshëm të specieve të faunës, dhe sigurimi i përditësimit dhe mirëmbajtjes së saj”, si përfitues të shtohen edhe “strukturat e administratës vendore të pyjeve, mjedisit, bujqësisë dhe territorit”. Këto përmirësime, lidhen me përgjegjësitë e njëjësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e mjedisit, pyjeve, natyrës dhe biodiversitetit, sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe janë rekomanduar për t’u përfshirë në dokumentin e “Planit të

Veprimet Kundër Helmimit të llojeve të kërcënuara dhe endemike të Faunës së Egër”, në pikat 1, 2, 3, 4 dhe tabelat përkatëse.

5. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave “Për lendfillet e mbetjeve”, të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ shprehën dakordësinë në parim.

Znj. Romina KUKO
Zv/Ministër i Brendshëm
Bashkëkryetar



Z. Aldrin DALIPI
Kryetar i Shoqatës së Këshillit
të Qarqeve të Shqipërisë
Bashkëkryetar

